



Përmbledhje e Planit Afatmesëm të Veprimit 2019-2021

Planit afatmesëm i Veprimit është hartuar duke u mbështetur fuqishëm në rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, përkatësisht nga raportet e asistencave teknike të ekspertëve të FMN-së në fusha të ndryshme brenda Administratës Tatimore të Kosovës. Po ashtu ky raport përfshin aktivitete duke u bazuar në strategjitë dhe planet vjetore të institucionit.

Synimi i këtij plani është përmirësimi i proceseve të punës, organizmi, qeverisja dhe menaxhimi më i mirë me burimet njerëzore dhe sfida të tjera madhore që ka përpara Administrata Tatimore.

Në kuadër të planit ne kemi paraqitur objektiva, në kuadër të të cilave janë vendosur aktivitetet që duhet të ndërmerren për arritjen e objektivave.

Objektivi 1. Rritja e saktësisë dhe besueshmërisë së regjistrit të tatimpagueseve, janë paraparë aktivitetet si në vijim :

- Të zhvillohen protokolle më të mira (dhe automatike) të shkëmbimit të të dhënave ndërmjet ATK-së, ARBK-së, AKK-së, komunave dhe zyrës së regjistrimit të OJQ-ve
- Të zhvillohen dhe zbatohen procedura të brendshme më efikase në ATK për përditësimin e të dhënave dhe pastrimin dhe identifikimin e tatimpaguesve joaktivë, përfshirë edhe pas regjistrimit fillestar.
- Të inkurajohen tatimpaguesit për përditësimin e detajeve të regjistrimit duke hequr pengesat dhe duke ofruar mundësi online.
- Të rekomandohen ndryshime në ligj për të ndëshkuar tatimpaguesit që nuk njoftojnë për ndryshimet kyçe në të dhënat e tyre të regjistrimit

Sa i përket këtij objektivi të parë Administrata Tatimore ka këmbim automatik të të dhënave me ARBK, e po ashtu këmbimi automatik i të dhënave në mes të ATK dhe OJQ është funksional.

ATK ka hartuar procedurat për pastrimin e llogarive tatimore, të cilat janë aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe si të tilla janë duke u implementuar.

Është zhvilluar Sistemi Elektronik EDI, përmes të cilit kërkohet plotësimi dhe freskimi i informatave të tatimpaguesit. Përmes këtij shërbimi, tatimpaguesi është i obliguar për përditësimin e informatave të tij, me qëllim që Administrata Tatimore të ketë informatat e sakta për të komunikuar me tatimpaguesin.

Objektivi 2. Rritja e përmbushjes së deklaramit me kohë, janë paraparë aktivitetet si në vijim :

- Të rekomandohen ndryshime në ligj për të aplikuar një regjim më efektiv të ndëshkimit për deklarim të vonuar dhe për të ndihmuar në korigjimin e numrit të deklaratave të pritshme për secilin lloj të tatimit.
- Krijimi i procedurave dhe strukturave efektive për zbutjen e mos-deklarimit dhe deklarimit të vonuar për të gjitha llojet dhe periudhat e tatimeve.
- Ofrimi i pakos informative mbi detyrimet tatimore për të gjithë regjistruarit e rinj.

Sa i përket objektivit të dytë janë realizuar këto aktivitete: Në mënyrë që tatimpaguesit të njihen në çdo hap për procedurat e kërkuara me legjislacionin tatimor, risitë dhe ndryshime të tjera, janë



përgatitur/ofruar – Njoftime për tatimpagues, përmes mediave, ueb-faqes së ATK-së, Facebook të ATK-së, përmes adresave elektronike të tatimpaguesve, Komunikata, Intervista për mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në vazhdimësi janë shqyrtuar kërkesat e parashtruara nga tatimpaguesit në afatin e paraparë ligjor. Pra, me qëllim të informimit të tatimpaguesve për përmbushjen e detyrimeve tatimore saktë dhe në kohë, ATK gjatë vitit 2020, ka publikuar dhe dërguar tek tatimpaguesit njoftimet përmes të cilave janë informuar për të gjitha obligimet e tyre.

Departamenti për Regjistrim dhe Shërbim të tatimpaguesve në vitin 2019 ka finalizuar pakon informative (fletushkat) mbi detyrimet tatimore për të gjithë regjistruerit e rinj, dhe si e tille kjo pako informative është përkthyer edhe në gjuhën serbe dhe angleze, është printuar dhe është shpërndarë në të gjitha Drejtoritë Rajonale dhe DTM, si dhe tek palët e interesit, përfshirë këtu Odat Ekonomike, Shoqatat e biznesit, etj. Po ashtu, gjatë vitit 2020 janë përgatitur edhe dy materiale informuese, si: Karta e tatimpaguesit dhe broshura “Përmbushja tatimore”.

Objektivi 3. Zvogëlimi i borxhit tatimor, janë paraparë aktivitetet si në vijim :

- Të sigurohet që të gjitha borxhet të cilave u ka kaluar afati ligjor i mbledhjes të higen rregullisht nga llogaritë e tatimpaguesve.
- Të zhvillohet një plan me afate të qarta kohore për zvogëlimin e nivelit të borxhit tatimor në më pak se 10 për qind e mbledhjes së përgjithshme.
- Të sigurohet që të gjitha borxhet e tjera të pa mbledhshme të barten në mënyrë sistematike në dosjen pasive.

Lidhur me këtë objektiv për shkak të Pandemisë Covid 19, dhe stafit të reduktuar ka ndikuar që proceset e planifikuara të mos realizohen sipas afatit të paraparë. Procesi i anulimit të borxheve të vjetruara është proces i vazhdueshëm. Gjatë vitit 2020 janë anuluar Borxhe në vlerë 11 ,101,812 euro ku prej tyre janë :

- a) 52 Subjekte private me vlerë totale 3,106.963.00€, të anuluar sipas Nenit 43.3 të Ligjit Nr. 03/L-222 për LATP
- b) 41 Subjekte (Ndërmarrje Shoqërore) me vlere 7,994,849.72€ anulime për borxhe të pa mbledhshme të përbëra nga ndëshkimet dhe interesi i mbetur pasi që këto ndërmarrje janë likuiduar dhe kanë përmbushur kërkesat kreditore të ATK-së.

Ofrimi i formës elektronike të parashtrimit të kërkesës për marrëveshje në rrethanat e krijuar për shkak të pandemisë ka dhënë rezultate konkrete. Gjatë viti 2020 janë lidh gjithsejtë 1726 marrëveshje me borxh të menaxhuar me marrëveshje 82.5 mil. dhe pagesa të kistit para marrëveshjes 13.5 mil.

Objektivi 4. Sigurimi që rimbursimi i TVSH-së të bëhet brenda 30 ditësh, janë paraparë aktivitetet si në vijim :

- Përmirësimi i vlerësimit automatik të rrezikut për të lehtësuar miratimin dhe pagesën e menjëhershme të kërkesave të TVSH-së me rrezik të ulët.
- Të kufizohen aktivitetet e verifikimit vetëm në transaksionet që lidhen me rimbursimin, përveç nëse paraqiten dëshmi të qarta që kërkojnë analizim më të gjerë.

Lidhur me këto aktivitetet ATK në fillim të vitit 2020 ka nxjerr një Rregullore mbi Procedurat e rimbursimit/kthimit të mjeteve dhe po ashtu ka nxjerr dokumentin e kritereve të Rimbursimit ku bazuar



në këto kritere sistemi në mënyrë automatike bën kategorizimin bizneseve sipas kategorisë A ,B dhe C. Sipas Rregullores dhe rekomandimeve të FMN-së nga data 12.02.2020 ka filluar se funksionuari Divizioni i Rimbursimeve që merret me trajtimin e të gjitha kërkesave për Rimbursim dhe për të gjitha llojet e tatimeve. Gjate këtyre periudhave nga lëndët e rimbursimeve të aprovuara në TVSH 85% janë kryer me aktivitet (kategoria A dhe B) dhe 15% me kontroll (kategoria C) e që është në përputhje me Rregulloren dhe rekomandimet e FMN-së. Sipas kategorive kemi këtë përqindje : Kategoria A-33%, kategoria B-52% dhe kategoria C-15% . Numri i lëndëve të rimbursimit të trajtuara gjatë vitit 2020 është 647 lëndë prej të cilave 460 janë të aprovuara dhe 187 lëndë janë të refuzuara.

Objektivi 5.Fuqizimi i procedurave të kontrollit, janë paraparë aktivitetet si në vijim :

- Të zhvillohet dhe zbatohet një plan për modernizimin e praktikave të kontrollit dhe ndarje më efektive të resurseve

Lidhur me këtë objektivi janë realizuar aktivitete, bazuar në planin e rishikuar të kontrollave gjatë vitit 2020 janë realizuar 1,014 apo 98.2% e tyre. Nga numri i përgjithshëm i kontrollave të përfunduara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, 36% e tyre janë propozuar nga Analiza e Riskut. Ndërsa gjatë kësaj periudhe nga DMR janë propozuar për kontroll gjithsej 377 raste, ku 279 apo 74% prej tyre janë trajtuar gjatë vitit 2020. Gjatë vitit 2020 janë realizuar 7,758 vizita përmbushëse dhe 22,167 aktivitete. Gjatë vitit 2020 në baza mujore përgatiten raportet e detajuara të kontrollave dhe të vizitave. Situata e krijuar në Kosovë nga pandemia COVID 19 ka ndikuar edhe tek Institucionet publike në ushtrimin e aktiviteteve të rregullta të tyre. Kjo situatë ka ndikuar para së gjithash në uljen e numrit të aktiviteteve që ATK ka ndërmarr në terren qoftë si rezultat i reduktimit të stafit dhe aktiviteteve apo edhe si rezultat i mbylljes së bizneseve.

Objektivi 6.Rritja e burimeve të informatave për krahasim, janë paraparë aktivitetet si në vijim:

- Zgjerimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar për të ndihmuar në identifikimin e evazionit nga banorët kosovarë me llogari dhe pasuri jashtë vendit.
- Rekomandimi i një ndryshimi në ligj për të lejuar raportimin automatik të informatave bankare të banorëve të Kosovës.
- Sigurimi që të gjitha informatat në dispozicion të palëve të treta të jenë të qasshme në mënyrë elektronike.

Ministri i Financave në një forum në Paris e ka ngritë çështjen e anëtarësimit të Kosovës në Forumin Global të Transparencës dhe Shkëmbimit të Informatave në një takim bilateral me personat përgjegjës ne OECD dhe përgjigja e tyre ishte se përderisa ky proces është me votim, është e vështirë që Kosova të mund të përfshihet në këtë mekanizëm. Gjithashtu në takimin e datës 10 Korrik 2019, të organizuar nga MPJ për grupin punues për Njohjen e Kosovës, përfaqësuesit e institucioneve janë pajtuar që anëtarësimet në organizata të huaja ose programe të huaja duhet të shkojnë përmes aprovimit në Qeveri dhe pastaj përmes MPJ-së, pasi që ndërlihet me njohjen e Kosovës.

Me rishikimin e Programit Legjislativ për vitin 2021 do të propozohen ndryshimet të cilat do të inkorporohen në draftin e ri të Projektligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat.



Objektivi 7. Përmirësimi i menaxhimit të përmbushjes, janë paraparë aktivitetet si në vijim :

- Përmirësimi i proceseve të vlerësimit të rrezikut për t'i mundësuar ATK-së të identifikojë grupet e rreziqeve kryesore që përbëjnë pjesën më të madhe të hendekut tatimor.
- Sigurimi që të gjitha aktivitetet operative udhëhiqen nga strategjitë për zbutjen e rrezikut të përmbushjes.
- Përpjekjet e përmbushjes monitorohen rregullisht për të vlerësuar ndikimin në sjelljen e tatimpaguesve.

Lidhur me objektivin e 7 janë zhvilluar këto aktivitete: Bazuar në Draft Planin e përgatitur, Divizioni i Riskut në planin vjetor të trajtimit të rreziqeve për vitin 2021, ka identifikuar disa grupe të tatimpaguesve të cilët në bazë të analizave të bëra kanë rezultuar të kenë shkallë të lartë të rrezikshmërisë në krahasim me grupet tjera të tatimpaguesve.

Është finalizuar dhe është në zbatim plani specifik për sektorin e Ndërtimtarisë ndërkohë është finalizuar dhe aprovuar plani edhe për sektorin e Akomodimit dhe Shërbimit Ushqimor. Po ashtu është duke u punuar në finalizimin edhe të dy planeve tjera, punësimi joformal dhe plani për mallra pa origjinë dhe mungesë në stoqe. Mirëpo marr parasysh pandeminë COVID 19, janë paraqitur disa vonesa të paplanifikuara nga ana jonë.

Gjatë vitit 2020, janë realizuar 96 kontrolle në sektorin e ndërtimit të cilat kanë rezultuar me tatim shtesë në vlerë prej 8.3 mil euro, kreditim i zbritur prej 875,694 euro si dhe zvogëlim i humbjes prej 2.7 mil. euro, janë realizuar po ashtu 264 vizita që si për rezultat kishin 12.7 mil euro qarkullim shtesë dhe 32,825 euro gjoba mandatorë.

Ndërsa sa i përket planit të akomodimit ky projekt nuk ka filluar së zbatuari si pasojë e gjendjes së pandemisë, përkundër kësaj gjate periudhës raportuese në këtë sektor kishim 33 kontrolle të kryera me 1.3 mil. euro tatim shtesë, ndërsa janë realizuar edhe 1,609 vizita me një qarkullim shtesë prej afro 1 mil euro si dhe 197,500 gjoba mandatorë.

Identifikimi i punëtorëve të pa regjistruar dhe trajtimi i tyre së bashku me MPMS përkatësisht inspektoratin e punës, është paraparë që të zhvillohet në kuadër të një projekti gjithëpërfshirës të përmbushjes. Draft projekti i përmbushjes për trajtimin e punësimit joformal është hartuar së bashku me planin e veprimit, mirëpo edhe ky projekt sikur edhe projektet tjera të përmbushjes nuk kanë mundur që të zbatohen si rezultat i pandemisë COVID-19, pavarësisht mosveprimit të koordinuar me MPMS në trajtimin e kësaj problematike, ATK nga aktivitet në terren gjatë periudhës raportuese ka regjistruar 2,265 punëtor, përveç kësaj zbatimi i masës 14 në kuadër të pakos fiskale emergjente ka ndikuar në regjistrimin apo formalizimin e afër 15,000 të punësuarve.

Objektivi 8. Harmonizimi i burimeve me ngarkesën e punës dhe rrezikun, janë paraparë aktivitetet si në vijim :

- Zhvillimi dhe zbatimi i një plani për të harmonizuar më mirë strukturën organizative dhe shpërndarjen e burimeve me ngarkesën e punës dhe rrezikun.
- Konsolidimi pilot (testues) i funksioneve të caktuara në një zyrë të vetme, për shembull mbledhja e borxheve.
- Sigurimi që stafi të akomodohet në ambiente të zyrave moderne.



Departamenti për mbledhjen e borxheve është konsoliduar dhe është duke funksionuar sipas procesit të ri të riorganizimit sipas parimit të kryerjes së proceseve të caktuara në Divizione, ku edhe mbyllen proceset dhe parimit të modernizimit të TI-së në përcjelljen e rasteve përmes sistemit të SMRM-së, duke u përkufizuar në afatet kohore të përcaktuara, ku rastet në mënyrë të automatizuar përcillen në rrjedhën e tyre përpara. DMB funksionon me katër divizione. Ky projekt i riorganizimit është i mbikëqyrur sipas kërkesave të parapara me projekt. Është formuar komisioni mbikëqyrës i projektit i cili përcjell këto procese. Departamenti i Proc.MD ka mbajtur Trajnimet e duhura, dhe atë dy here, Gjithashtu grupi punues ka përfunduar udhëzimin specifik për DMB në trajtimin e borxheve mbi 100 mij.€ Në proces është Aneksi dokumenti për Planin e uljes së borxhit tatimor 2019-2021 i cili duhet aprovuar nga menaxhmenti dhe të fillohet me punë.

Edhe përkundër kërkesave zyrtare të adresuara nga ana e ATK-së dhe premtimeve nga Ministria e Financave për fillimin e ndërtimit të një objekti të ri për ATK-në, ende nuk kemi diçka konkrete në këtë drejtim.

Objektivi 9. Përmirësimi i perceptimit të publikut për integritetin e ATK-së, janë paraparë aktivitetet si në vijim :

- Të ri-dizajnohen strukturat, proceset dhe politikat e BNJ-ve për të minimizuar fushat e diskrecionit dhe mundësitë për abuzim dhe korrupsion.
- Publikimi më i mirë i përpjekjeve të ATK-së për të trajtuar çështjet e integritetit për të përmirësuar besimin e publikut në administratën tatimore.

Lidhur me këtë objektiv janë zhvilluar këto aktivitete: Janë zhvilluar 4 tryeza me sektorin privat, media, OJQ-të dhe hulumtuese, punëtori dhe sesione, punë virtuale. Janë përfshi komentet e palëve të jashtme. Është aprovuar Plani i Përmirësimit të Integritetit të ATK-së 2020-2022 dhe Dokumenti i Indikatorëve.

Lidhur me çështjen e integritetit janë zhvilluar këto aktivitete kryesore gjatë vitit 2020: Hetimi i rasteve që kanë të bëjnë me integritet; Aprovimi dhe publikimi i Planit për Përmirësimin e Integritetit në ATK 2021-2023; Edukimi i stafit të ATK-së mbi etikën; Njoftimet e opinionit për masat e ndërmarra lidhur me çështje të korrupsionit; Bashkëpunimi me institucionet e luftimit të korrupsionit (Policia, Prokurori, Agjenci Kundër Korrupsion) dhe bashkëpunim dhe prezantim i aktiviteteve në publik sipas MiM në mes ATK-së, BIRN dhe Demokracia Plus; Menaxhimi i linjës online 0800-80-800; Njoftimet për çështje të evazionit, trajnime, seminare, etj. Hapat që do të ndërmerren për realizimin e aktiviteteve: Të publikohen të dhënat e hapura (Open Data); Të rriten kapacitetet për transparencë dhe komunikim me tatimpagues; Të rifreskohen dhe përditësohen informatat e publikuara për tatimpagues dhe ATK; Të realizohet edukimi fiskal për qytetar/tatimpagues; Të përmirësohet perceptimi lidhur me përzgjedhjen e tatimpaguesit për kontrollë;

Objektivi 10. Përmirësimi i kapacitetit për modernizim, janë paraparë aktivitetet si në vijim :

- Të krijohet një strukturë e përhershme, formale, e qeverisjes dhe menaxhimit të projektit për menaxhimin e reformave dhe shpenzimeve.
- Sigurimi që të ketë kapacitete të mjaftueshme të menaxhimit të ndryshimeve për të kryer me sukses projektin e modernizimit.



Në fund të vitit 2019 është rishikuar Struktura e Përgjithshme Organizative e ATK-së e cila përbëhet nga 3 shtylla kryesore: Operacione (shpërndarja), Programe dhe Procedura (hartimi) si dhe për Mbështetje të Programeve dhe Procedurave (përkrahja). Pjesë e kësaj Strukture Organizative është funksionalizimi i një strukture të përhershme formale e qeverisjes dhe menaxhimit të projekteve e quajtur "Departamenti për Zhvillim dhe Koordinim të Projekteve" i cili departament është pjese e shtyllës për Programe dhe Procedurave dhe cili i raporton zv.Drejtorit të Përgjithshëm për Programe dhe Procedura.

Në vitin fillim të vitit 2020 është rekrutuar një zyrtar i lartë tatimor në Divizionin për Zhvillim të Projekteve me qëllim rritjen e kapaciteteve ekzistuese, duke arritur në 3 numri i përgjithshëm i zyrtareve në këtë departament. Synimi është rritja e mëtejme e kapaciteteve në këtë departament me qëllim menaxhimin e ndryshimeve në ATK.

Objektivi 11.Zbatimi i strategjisë së rrezikut institucional dhe zbutjes, janë paraparë aktivitetet si në vijim:

- Të krijohet një regjistër i rreziqeve për mbarë institucionin dhe një plan i rimëkëmbjes në rast fatkeqësie i ndarë nga menaxhimi i rreziqeve të përmbushjes së tatimpaguesve.

Nga ATK nuk është marrë ndonjë veprim konkret meqë si veprim është i centralizuar dhe është duke u punuar që regjistri i rreziqeve institucionale të krijohet në nivel qendror për të gjitha institucionet e Kosovës.